



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:310620

Datë: 13.11.2024

Numri i dokumentit: 06446574

P.nr.488/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Dardane Ismaili me bashkëpunëtoren profesionale Liridona Musliu Bekteshi në çështjen penale ndaj të pandehurit: Sh.D. për shkak të veprave penale: Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së dhe Kanosja nga neni 181 par.2 të KPRK-së sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.1874/2024 të datës 04.11.2024, duke vendosur sipas kërkesës për shqiptimin e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datë 08.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.1874/2024 të datës 04.11.2024, andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje: KPPK), jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

Sh... D... nga i ati S..., e ëma I..., e vajzërisë J..., i lindur me datë ... në Vushtrri, me adresë të vendbanimit në rrugën "...", Vushtrri, me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me datë 08.10.2024, rreth orës 21:10, në rrugën K..., Mitrovicë Veri, saktësisht në lokalit .. i pandehuri Sh. D., në gjendje të dehur dhe atë 1.05 promil, e ka dëmtuar pasurinë e personi tjetër dhe atë pronën e dëmtuarës J.S., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje mes tyre, i pandehuri duke përdorur forcën për të mundur me hy brenda lokalit ka thyer xhamin e derës së hyrjes së lokalit, me q' rast me këtë veprim ka shkaktuar dëm material në pasurinë e të dëmtuarës.

-Me këtë ka kryer veprën penale: Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

Me datën, kohën dhe vendin si në pikën I të dispozitivit i pandehuri Sh.D. nën ndikimin e alkoolit, dhe atë 1.05 promil me qëllim të frikësimit, me fjalë seriozisht e kanos të dëmtuarën J. S., se do ti shkaktojë ndonjë të keqe, në atë mënyrë që gjersa e dëmtuara ishte në lokalit e saj, i pandehuri duke përdorur forcën e hap derën e lokalit, dhe fillimisht i drejtohet të dëmtuarës me fjalë: Pse e thirre policinë, e më pas e kanos me fjalët: “ Do të të vë zjarrin ty dhe lokalit kur të vij do të të vras”, të cilat fjalë tek e dëmtuara kanë shkaktuar ankth dhe pasiguri për jetën e saj.

-Me këtë ka kryer veprën penale:Kanosja nga neni 181 par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të nenit 1, 4 ,7 ,8, 17, 21, 38, 39, 40, 43, nenit 321 par.1 të KPRK-së dhe nenit 181 par.2 të KPRK-së, si dhe bazuar në nenet 364, 449, 493 dhe 495 të KPPK-së, të pandehurit i:

S H Q I P T O N

Për veprën penale si në pikën I të aktakuzës:

DËNIM ME GJOBË në shumë prej prej 200 (dyqind) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për veprën penale si në pikën II të aktakuzës:

DËNIM ME GJOBË në shumë prej prej 250 (dyqindpesëdhjetë) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veproj në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t’ia zëvendësoj me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 € (euro) gjobë me një (1) ditë burgim.

Në kuptim të nenit 76 të KPRK-së, të pandehurit Sh.D., gjykata i shqipton:

DËNIM UNIK ME GJOBË, në shumë prej 450 € (katërqindpesëdhjetë euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veproj në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t’ia zëvendësoj me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 € (euro) gjobë me një (1) ditë burgim.

-OBLIGOHET i pandehuri, t’i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro, dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 euro, apo shumën totale prej 40 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

E dëmtuara J.S. për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzë PP.II.1874/2024 të datës 04.11.2024, kundër të pandehurit: Sh.D. për shkak të veprës penale: Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së si dhe për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.2 të KPRK-së.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprat penale me të cilën akuzohet i pandehuri, ligjvënësi ka paraparë dënimin me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit. që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 dhe 494 të KPPK-së, Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së dhe konform dispozitave nga neni 495 par.1 të KPPK-së ashtu që morri vendim që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykatës i është kërkuar që kundër të pandehurit të jep Urdhër Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë së shtetit në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, si: Procesverbali i datës 08.10.2024 mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarës-dëshmitarës J.S., Procesverbali i datës 08.10.2024 mbi marrjen në pyetje të dëshmitarës S.R., Procesverbali i datës 09.10.2024 mbi marrjen në pyetje të të pandehurit Sh.D., Fotodokumentacioni në tërësi 7 fotografi, Raporti i oficerit i datës 08.10.2024 si dhe shkresat e tjera në lëndë. Të gjitha këto janë prova të besueshme të cilat vërtetojnë se në veprimet e të pandehurit Sh.D. ekzistojnë elemente të veprës penale: Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së si dhe veprës penale Kanosja nga neni 181 par.2 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhër ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, konform nenit 69 të KPRK-së, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar për të pandehurin është dënim i drejtë dhe i ligjshëm dhe është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale, me intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penale dhe rrethanat në të cilat janë kryer veprat penale.

Andaj gjykata vlerësoi se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në vështrim me nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryesit nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, vepra këto të cilat janë në rritje e sipër, të bëjë rehabilitimin e tyre, që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpërsojë dënimin kundër tyre, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngritë moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe ato për paushall gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 462 të KPP-së ashtu që të dëmtuarën e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 364, 449, 493 dhe 495 të KPPK-ës, nga arsyejet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.488/2024, datë 08.11.2024

GJYQTARJA
Dardane Ismaili

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimet të tij. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate.